

1854

95/4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHENDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SHERBIMIT SPITALOR PUKE

Nr. 254 protPuke me, 16 / 09. 2021

Lenda: Dergim informacioni

QENDRES "RES PUBLIKA"

Tirane

Per dijeni: KOMISIONERIT PER TE DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
ETE DHENAVE PERSONALE

Tirane

Ne pergjigje te kerkeses tuaj te dates 30.07.2021 "Kerkese per informacion dhe venie ne
dispozicion e dokumentacionit" ju informojme si me poshte:

Spitali Bashkiak Puke nuk ka qene pjese e skenareve per trajtimin e pacienteve te prekur nga
Covid -19, nisur nga kjo ne spitalin tone eshte kryer triazhimi i rasteve Covid -19 per 480
paciente

Ne spitalin bashkiak Puke nga viti 2019- 2021 jane kryer me sukses 92 nderhyrje kirurgjikale.
Ne kuader te investimeve gjate periudhes se pandemise jane shtuar linjat funksionale te burimeve
te oksigjenit duke plotesuar 100% nevojat per furnizimin e oksigjenit medikal.
Bashkelidhur kopje te kontratave te lidhura nga spitali Puke per furnizimin me oksigjen
medikal:

Kontrata me nr.367 prot date 19.11.2020 e lidhur per vitin 2020-2021(marrveshje kuader) sipas
planifikimit te bere ne vitin 2019 para fillimit te pandemise si dhe kontrata shtese per nevojat e
institucionit nr.98 prot date 11.03.2021(blerje e vogel)autorizuar nga MSHMS,Tirane.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

DREJTORI
Enver SULEJMANI



Adresa: "Rruga e Deshmoreve", Puke, Tel: 3552122240, E-mail: pukehospital@yahoo.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA SHËNDETËSISË DHE MBROJTËS SOCIALE

DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR

PUKË

Nr. 367 prot,

Date 19/11 / 2020

KONTRATE FURNIZIMI

"B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Antituberkulare, Antineoplastike dhe immunomodulatore, antiparazitare, dermatologjike, hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut dhe Sistemi Respirator", ndarë në 121 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj", publikuar ne faqen zyrtare te APP sipas Dokumentave Standarte te Tenderit, "Procedura e prokurimit- e Hapur" mbi Kufirin e Larte Monetar" prokurim me mjete elektronike-Mallra, me Lote:

Lot41 Oxygen me nr. REF-49423-02-05-2020.

Lidhet sot me date 19/11/2020 ndermjet Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Puke perfaqesuar nga z.Enver Sulejmani Drejtor i Spitalit Puke nga njera ane dhe Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "GTS-Gazra Teknike Shqiptare"sh.p.k. me NIPT J61905015B dhe "Meser Albagaz" shpk me NIPT K78317002F, përfaqesuar Operatori Ekonomik "GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k.me administrator zt. Besnik HALILI,sipas kontrates se bashkepunimit te BOE nr.360 rep. e nr.88/2 kol. date 12.03.2020, nga ana tjetere si kontraktues, qe merr persiper dorëzimin e mallit.

Neni 1

Përkufizime

Ne kuptimin e kesaj kontrate:

Me "Autoritet Kontraktor" do te kuptohet Drejtoria e Sherbimit Spitalor Puke ne adresen Qyteti Puke,

Me "Sipermarres" (Operator Ekonomik) do te kuptohet subjekti "GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k. me NIPT J61905015B, Adresa : Tirane Vaqarr VAQARR Vaqarr, Tirane,.

Me "Kontrate" do te kuptohet marreveshja e nenshkruar ndermjet paleve (shites dhe bleres), per nje veprim juridik te caktuar;

Neni 2

Baza ligjore

- Neni 705-756, te "Kodit Civil te Republikes se Shqiperise",
- Ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar,
- VKM nr.135 date 20.02.2013 "Per lejimin e Ministrise se Shendetesise per kryerjen e proceduarve te prokurimit Publik ne emer dhe per llogari te institucioneve te varesise,per disa mallra e sherbime", te ndryshuar,
- VKM nr.914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave Te Prokurimit Publik",te ndryshuar,

Adresa: "Rruga e Deshmoreve",Puke,Tel:++ 35521222249 ,email: pukespitali@yahoo.com



Shkresa e Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale me nr.457/46 prot.date 29.04.2020, Marreveshje Kuader (ku te gjitha kushtet jane te percaktuara) MALLRA.

Shkresa e Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale nr.457/47 prot.date 29.04.2020, Formulart e Njoftimit te Operatoreve Ekonomike te Suksesshem ne Marreveshjen Kuader".

Shkresa e Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale nr.457/45 prot.date 27.04.2020.

h) Kontrate Bashkepunimi te Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "GTS-Gazra Teknike Shqiptare"sh.p.k. me NIPT J61905015B dhe "Meser Albagaz" shpk me NIPT K78317002F, perfaqesuar Operatori Ekonomik "GTS-Gazra Teknike Shqiptare" sh.p.k.me administrator zt. Besnik HALILI,

i) Formularet e Ofertes Ekonomike sipas loteve.

Neni 3

Objekti i Kontrates

Objekti i kesaj kontrate do te jete: "B1-Blerje barna Anti-infektive te pergjithshem, Anestezi Reanimacion, Antituberkulare, Antineoplastike dhe immunomodulatore, antiparazitare, dermatologjike, hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese te gjakut dhe Sistemi Respirator", ndare ne 121 lote - Marrveshje Kuader me disa operator ekonomik (nje OE te vetem te suksesshem per sejcilin lot)- ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj", publikuar ne faqen zyrtare te APP sipas Dokumentave Standarte te Tenderit, "Procedura e prokurimit- e Hapur" mbi Kufirin e Larte Monetar" prokurim me mjete elektronike-Mallra, me Lote:

Lot41 Oxygen me nr. REF-49423-02-05-2020, sipas Aneksit Nr.1 bashke lidhur Kontrates.

Pala "Blerese" merr persiper financimin, per furnizimin me mallin e mesiper.

Sipas Marreveshjes Kuader, Autoriteti Kontraktor i perfshire ne kete marreveshje do te bleje artikujt ne baze te kesaj marreveshje sipas fteses per oferte qe do te dergoje tek kontraktuesi duke specifikuar listen me artikujt per furnizim e mallrave te percaktuara ne kete kontrate, sipas formularit te Deklarimit te Ofertes te paraqitur nga Ofertuesi, Specifikimeve teknike dhe Formularin e Cmimit te Ofertes.

Autoriteti Kontraktor mund te bleje me pak ose me shume se sasite e parashikuara per sejcilin nga artikujt e listes se lotit, por ne cdo rast duke iu referuar atyre te kerkuara dhe brenda vleres totale te perlllogaritur te marrveshjes kuader per sejcilin lot, per cdo Autoritet Kontraktor, sipas plan shperndarjes se publikuar me DST.

Nuk lejohet tejkalimi i vleres se pritshme te lotit, te parashikuar per sejcilin Autoritet Kontraktor, referuar plan shperndarjes se cdo loti.

Neni 4

Vlera e Kontrates

Vlera e kontrates eshte 345.600 (treqind e dyzet e pesemije e gjashteqind) leke.

Palet bien dakort t'i qendrojne vleres se kontrates, me kushtin qe vlera te shprehet ne leke shqiptare.

Neni 5

Burimet e financimit

Burimet i financimit nga FSDKSH.



Adresa: "Rruga e Deshmireve", Puke, Tel: + 35521222240, email: pukespitoli@yahoo.com

Neni 6

Pagesa

Likudimi i vleres se kontrates do te behet brenda 30 diteve nga dorezimi i mallit (pervec rasteve kur ka rrethime me Thesarin).

Palet bien dakort qe oferta ne APP bashkengjitur eshte percaktuese ne vleren e kontrates.

Pagesa nga ana e "Bleresit", Drejtoria e Sherbimit Spitalor Puke, do t'i behet operatorit ekonomik sipermarres "GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k. me NIPT J61905015B, Adresa: Tirane Vaqarr VAQARR Vaqarr, Tirane, me Urdher Xhirimi ne llogarine nr. 30466935304 ne banken "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" ne qytetin e Tiranës dhe IBAN: AL13208111010000030466935304

Neni 7

Menyra e pageses

Pagesa nga investitori do bëhet, gjithnje sipas kerkeses se sipermarresit.

Pagesa do behet me leke shqiptare ashtu siç percaktohet ne formularin e kontrates dhe nenin 4 te kesaj kontrate.

Neni 8

Perfaqesues te autorizuar

Perfaqesues i autorizuar nga pala e bleresit per kryerjen e veprimeve financiare eshte zj.Donika Aliaj, me detyre Shefe e Finances, ne Drejtorine e Sherbimit Spitalor Puke.

Neni 9

Hyrja ne fuqi dhe perfundimi i kontrates

Data e hyrjes ne fuqi e kontrates eshte data e nenshkrimit nga palet me date 19/11/2020.

Data e përfundimit te kontrates do te jete **29.04.2022 (24 muaj nga nenshkrimi i MK ne Ministrine e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale, e cila eshte nenshkruar me date 29.04.2020, shkresa nr.457/46 prot.date 29.04.2020 "Marreveshje Kuader"**(ku te gjitha kushtet jane te percaktuara MALLRA)

Per mos realizimin e furnizimit brënda afatit dhe sipas specifikimeve teknike te paraqitura nga Autoriteti Kontraktor ne dokumentacionin e tenderit, furnizuesi mban përgjegjesi ligjore dhe "investitorit" i lind e drejta te aplikoje penalitete sipas nenit 15 te kesaj kontrate.

Neni 10

Dokumentat e Kontrates

Si pjese perberese e kontrates te cilat do ju referohen palet gjate zbatimit te saj do te jenë :

Sigurimi i kontrates

Aneksi Nr.1 bashkelidhur kontrates

Formulet e Ofertes Ekonomike

Kushtet e pergjithshme

Kushtet e vecanta

Kushtet e vecanta te Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

Në rast konflikti, Kushtet e Vecanta do të mbizotërojnë Kushtet e Përgjithshme.

Neni 11

Garancia e Kontrates

Garanci e kontrates do te sherbeje shuma prej 10% e vleres se kontrates.

Neni 12

Te drejtat dhe detyrimet e palëve

a. Te drejtat dhe detyrimet e Bleresit :

"Bleresi" detyrohet te paguaje sipermarrresin per furnizimin e kryer sipas detyrimeve te perckatuara ne nenin 3 dhe 4 te kesaj kontrate.

"Bleresi" eshte i detyruar qe, me paraqitjen e faturave siç percaktohet ne nenin 6 dhe 7 te kesaj kontrate, te beje likujdimin financiar per furnizimin e kryer.

b. Te drejtat dhe detyrimet e Shitesit:

"Shitesi" eshte i detyruar qe te realizoje furnizimin me cilesi, sipas grafikut te percaktuar te kontrates (Aneksi nr.1) bashkelidhur dhe sipas kushteve te percaktuara nga bleresi.

Neni 13

Marrja ne dorezim e mallit

Marrja ne dorezim e mallit nga bleresi behet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor.

Shitesi eshte i detyruar t'i dorezoje bleresit te gjithe dokumentacionin teknik te nevojshem per kete qellim.

Malli levrohet nga shitesi ne magazinën e Spitalit Puke me cmimet e percaktuara ne preventiv (ne cmim jane te perfshira te gjitha detyrimet fiskale dhe shpenzimet e transportit deri ne destinacion)

Furnizuesi eshte i detyruar te levroje te gjitha sasine e kontraktuar brenda 24 muajve nga lidhja e kontrates sipas Marreveshjes Kuader, sipas afateve te vendosura ne aneksin nr.1 te kontrates.

Bleresi njofton me telefon ose me email furnizuesin **5 dite para** dates per llojin e mallit dhe sasiste e furnizimit qe do te kryhen nga shitesi, (per furnizimet normale).

Bleresi eshte i detyruar te krijoj kushte per marrjen e mallit ne dorezim me mberritjen e tij ne magazine, por transportimi deri ne magazine do te behet nga punonjesit e furnizuesit.

Si dite e furnizimit do te konsiderohet data e mberritjes se mallit ne magazinën e bleresit.

Malli i furnizuar do te shoqerohet me:

a) fature shitje

b) afati i skadences : Data e skadences ne ditën e levimit te mallit duhet te jete jo me e vogel se ½ e kohes ndermjet dates se prodhimit dhe asaj te skadences, por ne cdo rast jo me e vogel se 12 muaj.

c) Formë – doza, njësia dhe volumi për secilin bar është përcaktuar në DST dhe është detyruese.

d) Konfeksionimi: Mbi cdo konfeksion duhet të jetë shënuar emri i barit, formë-doza, kodi i barit, përqindja dhe përmbajtja, data e prodhimit dhe e skadimit, nr. i serisë, dhe vula «PËRDORIM SPITALOR – NDALOHET SHITJA».

e) Të gjitha barnat duhet të jenë të pajisura me pullën e kontrollit të barnave të lëshuar nga AKBPM.

Neni 14

Zgjidhja e Mosmarreveshjeve



Adresa: "Rruga e Deshmorëve", Puke, Tel: + 35521222140, email: pukespitali@yahoo.com

Çdo mosmarrveshje midis paleve mund të zgjidhet me mirëkuptim mes tyre. Në rast të kundërt secila nga palet duhet të njoftojë me shkrim për shkakun e kundërshtimit duke caktuar një takim nga dy palet, për të zgjidhur mosmarrveshjen.

Për çdo mosmarrveshje që nuk zgjidhet me mirëkuptim, palet duhet t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Puke.

Neni 15

Sanksione

Nëse sipërmarrësi nuk përmbush, në mënyrë të rregullt, detyrimet kontraktore, blerësi ka të drejtë ta penalizojë sipërmarrësin, për çdo ditë vonës me 4/1000 e vlerës së kontratës së mbetur pa likuiduar, por jo më pak se 25 % të vlerës së saj.

Neni 16

Prishja e Kontratës

Sipërmarrësi mund të prishë kontratën me investitorin dhe anasjelltas, nëse njëra nga palet bën shkelje themelore të kontratës, gjë që e privon palën tjetër nga parimet kryesore të kontratës.

Në rast se kontrata priset nga një shkelje themelore e bërë nga pala e sipërmarrësit, investitorit i linden keto të drejta:

Të bëjë sekuestrimin e sigurimit të kontratës me vlerën e përcaktuar në nenin 11, pikë 1.

Të negociojë me operatorin që është klasifikuar i dyti në prokurim

Neni 17

Dispozita të fundit

Palet nuk do të penalizohen për mosrealizimin e kësaj kontrate apo kur realizimi i saj me vonesë ndodh për shkak të forcave mëdha.

Kjo kontratë mbyllet me 17 nënë dhe 6 faqe tekst dhe anekset e shprehura në nenin 10 të kontratës.

Kontrata hartohet në 6 (gjashtë) kopje dhe pasi lexohet nënshkruhet e vulloset me pelqimin e paleve, sot me datë 19 / 11 / 2020.

Shenim: Një kopje në dosjen e tenderit Zv.Drejtori Ekonomik, një kopje operatori ekonomik, një kopje në Degen e Thesarit Puke, një kopje Shefi i Finances, një kopje në Arshive dhe një kopje magazinierit.

“SHITESI”

“BLERESI”

“GTS-Gazra Teknike Shqiptare”sh.p.k.


DREJTORIA SHERBIMIT SPITALOR PUKE

ADMINISTRATOR

DREJTORI

BESNIK HALILI

ENVER SULEJMANI



Aneksi Nr.1

Lot	Sistemi	Princip i aktiv	Formë/doza	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Kompania prodhuese/M AH	Vendi i prodhimit	Afatet e Levimit të mallit	
										Viti 2020-2021	Sasia
Lot 41	Anestezi Reanimacion	Lot41 Oxygen	Gaz per perdorim mjeksor, i kompresuar x 100%	Litra	10,000	34.56	345,600	"GTS-Gazra Teknike Shqiptare"/ Messer Albagaz	SHQIPERI	Sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor Drejt orise se Sherbimit Spitalor Puke	10,000
Çmimi total							345,600			Shuma	10,000
ÇMIMI TOTAL I KONTRATES							345,600				

"SHITESI"

"BLERESI"

"GTS-Gazra Teknike Shqiptare"sh.p.k.

DREJTORIA SHERBIMIT SPITALOR PUKE

ADMINISTRATOR

BESNIK HALILI

DREJTORIE SHQIP
ENVER SULEJMANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA SHËNDETËSISË DHE MBROJTËS SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR
PUKË

Nr. 98 prot,

Date 11.03.2021

KONTRATE FURNIZIMI

Lidhet sot me date 11 / 03 / 2021 ndermjet Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Puke perfaqesuar nga z.Enver Sulejmani Drejtor i Spitalit Puke nga njera ane dhe Operatorit Ekonomik "GTS-Gazra Teknike Shqiptare" sh.p.k. me NIPT J61905015B, perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor z.Besnik HALILI, nga ana tjetere si kontraktues, ne vijim te procedures se prokurimit me mjete elektronike me REF-89419-03-09-2021 "Blerje me vlere te vogel" te publikuar ne faqen zyrtare te Agjensise se Prokurimit Publik, qe merr persiper dorëzimin e mallit.

Neni 1

Përkufizime

Ne kuptimin e kesaj kontrate:

Me "Autoritet Kontraktor" do te kupfohet Drejtoria e Sherbimit Spitalor Puke ne adresen Qyteti Puke,

Me "Sipermarres" (Operator Ekonomik) do te kuptohet subjekti "GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k. me NIPT J61905015B, Adresa : Tirane Vaqarr VAQARR Vaqarr, Tirane,.

Me "Kontrate" do te kuptohet marreveshja e nenshkruar ndermjet paleve (shites dhe bleres), per nje veprim juridik te caktuar;

Neni 2

Baza ligjore

- a) Neni 705-756, te "Kodit Civil te Republikes se Shqiperise",
- b) Ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar,
- c) VKM nr.914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave Te Prokurimit Publik",te ndryshuar,
- d) Shkresa e Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale me nr.5274 prot.date 25.11.2020, "Mbi prokurimin e oksigjenit mjeksor ne kuader te COVID-19",
- e) Urdheri Nr.22 date 08.03.2021 "Per krijimin e Komisionit te Prokurimit me vlere te vogel,
- f) Urdheri Prokurimit nr.23 date 08.03.2021 "Per Prokurimin me vlere te vogel"
- g) Formulari i Çmimit te Ofertes Ekonomike,
- h) Formulari i Njofimit te Fituesit Nr.CN/96335/03092021,

Neni 3

Objekti i Kontrates

Objekti i kesaj kontrate do te jete: "Blerje Oksigjen i gazte mjekesor per Spitalin Puke" publikuar ne faqen zyrtare te APP sipas Dokumentave Standarte te Tenderit, "Procedura e prokurimit- Blerje me vlere te vogel" prokurim me mjete elektronike-Mallra, me nr. REF-89419-03-09-2021,sipas Aneksit Nr.1 bashke lidhur Kontrates.



Pala "Blerese" merr persiper financimin, për furnizimin me mallin e mesiperm.

Autoriteti Kontraktor i perfshire ne kete marreveshje do te bleje artikujt ne baze te kesaj marreveshje si fteses per oferte qe do te dergoje tek kontraktuesi duke specifikuar listen me artikujt per furnizim e mallrave te percaktuara ne kete kontrate, sipas formularit te Deklarimit te Ofertes te paraqitur nga Ofertuesi. Specifikimeve teknike dhe Formularin e Çmimit te Ofertes.

Autoriteti Kontraktor mund të blejë më pak ose më shumë se sasitë e parashikuara për sejcilin nga artikujt e listës, por në çdo rast duke iu referuar atyre të kërkuara dhe brenda vlerës totale të përlogaritur të kesaj kontrate.

Nuk lejohet tejkalimi i vlerës së pritshme të pervec sasise se parashikuar nga Autoritet Kontraktor, sipas kesaj procedure prokurimi.

Neni 4

Vlera e Kontrates

Vlera e kontrates eshte 691,200 (gjashteqind e nentendhjetë e nje mije e dyqind) leke.

Palet bien dakort t'i qendrojne vleres se kontrates, me kushtin qe vlera te shprehet ne leke shqiptare.

Neni 5

Burimet e financimit

Burimet i financimit nga FSDKSH.

Neni 6

Pagesa

Likujdimi i vleres se kontrates do te behet brenda 30 diteve nga dorezimi i mallit (pervec rasteve kur ka probleme me Thesarin).

Palet bien dakort qe oferta ne APP bashkengjiitur eshte percaktuese ne vleren e kontrates.


Pagesa nga ana e "Bleresit", Drejtoria e Sherbimit Spitalor Puke, do t'i behet operatorit ekonomik sipermarres "GTS-Gazra Teknike Shqiptare sh.p.k. me NIPT J61905015B, Adresa : Tirane Vaqarr VAQARR Vaqarr, Tirane, me Urdher Xhirimi ne llogarine nr. 30466935304. ne banken " _ Intesa San Paolo " ne qytetin Puke e IBAN: AL13208111010000030466935304.

Neni 7

Menyra e pageses

Pagesa nga investitori do bëhet, gjithnjë sipas kerkeses se sipermarresit.

Pagesa do behet me leke shqiptare ashtu siç percaktohet ne formularin e kontrates dhe nenin 4 te kesaj kontrate.



Neni 8

Perfaqesues te autorizuar

Perfaqesues i autorizuar nga pala e bleresit per kryerjen e veprimeve financiare eshte zj.Donika ALIAJ, me detyre Shefe e Finances, ne Drejtorine e Sherbimit Spitalor Puke.

Neni 9

Hyrja ne fuqi dhe perfundimi i kontrates

Data e hyrjes ne fuqi e kontrates eshte data e nenshkrimit nga palet me date **11/03/2021**.

Data e perfundimit te kontrates do te jete **10.03.2022 (12 muaj nga nenshkrimi i kesaj marreveshje(kontrate).**

Per mos realizimin e furnizimit brënda afatit dhe sipas specifikimeve teknike te paraqitura nga Autoriteti Kontraktor ne dokumentacionin e tenderit, furnizuesi mban pergjegjesi ligjore dhe "investitorit" i lind e drejta te aplikojë penalitete sipas nenit 15 te kësaj kontrate.

Neni 10

Dokumentat e Kontrates

Si pjese perberese e kontrates te cilat do ju referohen palet gjate zbatimit te saj do te jenë :

Sigurimi i kontrates

Aneksi Nr.1 bashkelidhur kontrates

Formularet e Ofertes Ekonomike

Kushtet e pergjithshme

Kushtet e vecanta

Kushtet e vecanta të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

Në rast konflikti, Kushtet e Vecanta do të mbizotërojnë Kushtet e Përgjithshme.

Neni 11

Cdementimet

1.Cdo dorezim malli do te behet me procesverbal, ku do te percaktohet sakte numri i bombulave plote qe do te lihen ne perdorim te Autoritetit Kontraktor dhe numri i bombulave boshe qe do te terhiqen nga Operatori Ekonomik.

2.Ne rast konstatimi te demtimit apo humbjes se bombulave nga Autoriteti Kontraktor, ky i fundit eshte i detyruar te paguaje vleren 25000 lek.

3.Ne rast konstatimi te demtimit apo humbjes se ventilave nga Autoriteti Kontraktor, ky i fundit eshte i detyruar te paguaje vleren 2500 Leke.

Neni 12

Garancia e Kontrates

Si garanci e kontrates do te sherbeje shuma prej 10% e vleres se kontrates.



Neni 16

Sanksione

Nëse sipërmarrësi nuk përmbush, në mënyrë të rregullt, detyrimet kontraktore, blerësi ka të drejtë ta penalizojë sipërmarrësin, për çdo ditë vonës me 4/1000 e vlerës së kontratës së mbetur pa likuiduar, por jo më pak se 25 % të vlerës së saj.

Neni 17

Prishja e Kontrates

Sipërmarrësi mund të prishë kontratën me investitorin dhe anasjelltas, nëse njëra nga palët bën shkelje themelore të kontratës, gjë që e privon palën tjetër nga parimet kryesore të kontratës.

Në rast se kontrata prishet nga një shkelje themelore e bërë nga pala e sipërmarrësit, investitorit i lindin keto të drejta:

Të bëjë sekuestrimin e sigurimit të kontratës me vlerën e përcaktuar në nenin 11, pikë 1.

Të negociojë me operatorin që është klasifikuar i dyti në prokurim

Neni 18

Dispozita të fundit

Palet nuk do të penalizohen për mosrealizimin e kësaj kontrate apo kur realizimi i saj me vonesë ndodh për shkak të forcave madhore.

Kjo kontratë mbyllet me 17 nene dhe 6 faqe tekst dhe anekset e shprehura në nenin 10 të kontratës.

Kontrata hartohet në 6 (gjashtë) kopje dhe pasi lexohet nënshkruhet e vuloset me pelqimin e paleve, sot me datë 11.03.2021.

Shënim: Një kopje në dosjen e tenderit Zv.Drejtori Ekonomik, një kopje operatori ekonomik, një kopje në Degen e Thesarit Puke, një kopje Shefi i Finances, një kopje në Arshive dhe një kopje magazinierit.

Neni 19

Forca Madhore

1. Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
2. Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
3. Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.



"SHITESI"

"GTS-GAZRA TEKNIKE SHQIPTARE" sh.p.k.

Perfaqesues Ligjor

BESNIK HALILI




"BLERESI"

DREJTORIA SHERBIMIT SPITALOR PUKE

DREJTORI

ENVER SULEJMANI



Aneksi Nr.1

	Sistemi	Principi aktiv	Formë/doza	Sasia	Çmimi	Vlera	Kompania prodhuese/MAH	Vendi i prodhimit
1	Anestezi Reanimacion	Oxygen	Gaz per perdorim mjeksor, i kompresuar x 100%	20,000	34.56	691,200	*GTS-Gazra Teknike Shqiptare*/ Messer Albagaz	SHQIPERI
ÇMIMI TOTAL I KONTRATES						691,200		

“SHITESI”

“BLERESI”

“GTS-GAZRA TEKNIKE SHQIPTARE”sh.p.k. DREJTORIA SHERBIMIT SPITALOR PUKE

Perfaqesues Ligjor

DREJTORI

BESNIK HALILI

ENVER SULEJMANI

